



Zyra e Kryetarit të komunës
Nr.02/Zyrtarisht
Datë: 05.08.2020

Në bazë të Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-212, nenit 8, paragrafi 1 dhe 2, Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, neni 4, Kryetari i Komunës Shpall këtë:

K O N K U R S

Institucioni:	Komuna e Deçanit
Drejtorja:	Administratë
Titulli i vendit të punës:	Roje Objekti
Kategoria funksionale:	Koeficienti- 4
Numri Ekzekutues:	1 (një) Punëtor

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Sigurimi fizik i Objektit të komunës gjatë natës, ditëve jo të punës si dhe festave Shtetërore;
- Kryerja e punëve në baze të kërkesave të Drejtorit për Administratë;
- Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës rreth detyrave në punë, dhe përgjegjësi të punës;
- Të njoftoj me kohë për problemet apo vështirësitë në punë.

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Shkathtësi për të organizuar punën e vet;
- Aftësi komunikimi;

Shkollimi i kërkuar: Shkolla e Mesme

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejte aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, kanë përgatitjen e nevojshme shkollore dhe aftësi fizike që kërkohet për pozitën përkatëse.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatet e interesuar.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në ndërtesën e Komunës pranë: **Zyrës Pritëse**. Konkursi mbetet i hapur **15** dite nga dita e publikimit nga data: **05-08.2020 deri 19-08.2020**.

Aplikacionit i bashkëngjitet: kopja e dokumentacionit mbi kualifikimin, Ekstraktin e lindjes, Letërnjoftimi i Republikës së Kosovës, Vërtetim që nuk është nën hetim.

Kandidatet të cilët për zgjidhen në listën e ngushtë për interviste njoftohen me shkrim ose në telefon në afat ligjor, kandidatet janë të obliguar që të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimin, trajnimet dhe të gjitha ato dokumente të cilat janë dorëzuar në aplikacion, dhe të cilat duhet të verifikohen nga Komisioni intervistues.

“Ligji i Punës i Republikës së Kosovës u shërben të gjithë banorëve të Kosovës dhe mirëpret aplikimet nga femrat dhe meshkujt e të gjitha komuniteteve të Kosovës”.

Kryetari i komunës:

Bashkim RAMOSAJ